



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA DURRËS**  
**DREJTORIA BURIMEVE NJERËZORE**

**NJOFTIM PËR VENDE TË LIRA PUNE**

Në zbatim të ligjit nr.89/2022 “Për Policinë Bashkiake”, VKM nr.525 datë 11.09.2018 “Për disa ndryshime në Vendimin nr.313 datë 01.07.2002 të Këshillit të Ministrave, “Për caktimin e strukturës, të numrit të punonjësve dhe shpenzimeve buxhetore të Policisë së Bashkisë dhe Komunës” i ndryshuar”, ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, si dhe në Urdhërin nr.434 prot.13363 datë 15.11.2024 ”Për shpalljen e konkurimit për pozicionet e lira pranë Drejtorisë së Policisë Bashkiake”, Bashkia Durrës shpall konkurimin për vende të lira pune në pozicionet :

**1.Polic pranë Sektorit të Kontrollit të Territorit (1 pozicion)**

*Kriteret për pranim :*

- Të jetë shtetas shqiptar;
  - Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
  - Të jetë në kushte shëndetësore që lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
  - Ndaj tij të mos jetë nisur një procedim penal dhe të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo një kundërvajtje penale;
  - Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna që nuk është shuar ose të mos ketë masë disiplinore në fuqi.
  - Të mos jetë larguar nga Policia e Shtetit për shkak të vlerësimeve kalimtare ose periodike , të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për punonjësit e Policisë së Shtetit
  - Të paraqesë vërtetimin e besueshmërisë.
- a) Përshkrimi specifik i punës për pozicionin Polic pranë Sektorit të Kontrollit të Territorit : Të paraqitet në ambjentet e zyrave 20 minuta para marrjes së detyrës;
  - b) Të marrë pjesë në instruktazh, të jetë i qethur, i rruar, me uniformë të pastër e të hekurosur;
  - c) Të njohë aktet ligjore dhe nënligjore që e ngarkojnë atë me detyrë dhe ti zbatojë ato me përpikmëri;
  - d) Të njohë me përpikmëri detyrimet që ka në vendin e shërbimit sipas planizimit të bërë në librin e shërbimit;
  - e) Të ruajë dhe sigurojë objektet ku është planizuar me shërbim;
  - f) Të mos lejojë parkimin e automjeteve në pjesën para Bashkisë;
  - g) Të mos lejojë qëndrimin dhe grumbullimin e qytetarëve përpara hyrjes kryesore përveç rasteve të tubimeve dhe protestave të njoftuara, që janë me leje nga Policia e Shtetit;
  - h) Gjatë natës shërbimit e kryen me lëvizje, duke u larguar Jo më shumë se 15m nga hyrja kryesore;
  - i) Të informojë sallën e informacionit dhe për çdo problem që mund të ketë dhe nuk i jep zgjidhje gjatë kryerjes së detyrës;
  - j) Të njoftojë autoritetet kompetente në rast ngjarjesh;

- k) Të marrë dhe dorëzojë shërbimin me proces-verbalin përkatës në librin e marrjes dhe dorzimit të shërbimit kundrejt firmës duke kontrolluar të gjithë objektin;
- l) Të mos tërheqë vemëndjen nga shërbimi kur i drejtohen shtetas të ndryshëm, për ti sqaruar, të përgjigjet shkurt dhe me etikë;
- m) Të mos lejojë prerjen e pëmeve aty ku ka të tilla;
- n) Të mos lejojë lëvizjen e qenve pa maska, si dhe të këshillojë pronarët e kafshëve që mos ti lëshojnë pasi përbëjnë rrezik për qytetarët e tjerë;
- o) Të sqarojë qytetarët për probleme në lidhje me Bashkinë duke i drejtuar për në Zyrën e Pritjes së Qytetarëve pranë Bashkisë Durrës;
- p) Të jetë i disiplinuar e korrekt gjatë kryerjes së shërbimit;
- q) Të mos largohet nga vendi i shërbimit për asnjë arsye pa lejen e eprorit gjatë orarit të punës;
- r) Të përpilojë raport shërbimin kur është e nevojshme dhe ta dorëzojë atë tek eprorët më të afërt në afat, duke bërë dhe dokumentimin e tij;

Programi i Konkurimit : Ligji nr.89/2022 “Për Policinë Bashkiake”, ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

Fazat e konkurimit:

a-Testim me shkrim, 60 pikë

b-Testim i aftësive fizike, 20 pikë

c-intervista, 20 pikë

Kandidati duhet të paraqesë brenda datës 25.11.2024 me postë , pranë Sektorit të Marrëdhënieve me Publikun, ose në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore këto dokumenta :

1. Kërkesën për aplikim
2. Jetëshkrim
3. Fotokopje të Diplomës së shkollës.
4. Fotokopje të librezës së punës
5. Dëshmi kualifikimi për kompjuterin
6. Vlerësim pune nga punëdhënësi i mëparshëm
7. Fotokopje e kartës së idenditetit.
8. Dëshmi e gjendjes gjyqësore.
9. Vërtetim Prokurori, Gjykatë
10. Dëshmi e gjendjes shëndetësore

### **Polic pranë Sektorit të Qarkullimit (1 pozicion)**

*Kriteret për pranim :*

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të jetë në kushte shëndetësore që lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Ndaj tij të mos jetë nisur një procedim penal dhe të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo një kundërvajtje penale;

- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna që nuk është shuar ose të mos ketë masë disiplinore në fuqi.
- Të mos jetë larguar nga Policia e Shtetit për shkak të vlerësimeve kalimtare ose periodike , të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për punonjësit e Policisë së Shtetit
- Të paraqesë vërtetimin e besueshmërisë.

Përshkrimi specifik i punës për pozicionin Polic pranë Sektorit të Qarkullimit : Polici varet direkt nga Inspektori dhe ka këto detyra e përgjegjësi:

- a) Merr pjesë në instruktazh, të jetë i qethur, i rruar, me uniformë të pastër e të hekurosur;
- b) Të ketë me vete pajisjet personale për kryerjen e detyrave;
- c) Të njohë dhe zbatojë me përpikmëri aktet ligjore dhe nënligjore që e ngarkojnë atë me detyrë dhe ti zbatojë ato me përpikmëri;
- d) Të zbatojë me përpikmëri dhe në nivel të lartë profesional të gjitha detyrat e caktuara nga eprorët e tij;
- e) Të njohë me përpikmëri detyrimet që ka në sektorin e shërbimit sipas planizimit të bërë në librin e shërbimit;
- f) Merr të gjitha informacionet që i jepen në radio e telefon, që lidhen me detyrën, t'i ezaurojë në kohën më të shkurtër ato dhe për masat e marra t'i raportojë eprorëve të vet më të afërt ;
- g) Të njoftojë autoritetet kompetente në rast ngjarjesh;
- h) Merr takim gjatë dinamikës ditore me patrullat e përgjithshme të policisë së shtetit dhe të bashkëpunojë më ta, duke kërkuar mbështetjen e tyre gjatë kryerjes së detyrës;
- i) T'u japë ndihmë të gjithë personave në nevojë, në rast të fatkeqësive natyrore;
- j) Të zbatojë me korrektësi kodin e etikës së punonjësit të policisë;
- k) Të sigurojë dinjitetin e punonjësit të Policisë Bashkiake gjatë komunikimit në zbatim të ligjit;
- l) Të jetë i disiplinuar e korrekt gjatë kryerjes së shërbimit;
- m) Të evidentojë në mungesë të drejtuesit të mjetit kundërvajtjet administrative në fushën e qarkullimit rrugor;
- n) Të njoftojë menjëherë operatorin e hedhjes së të dhënave, duke i raportuar këto të dhëna: tipin, targën e mjetit, vendndodhjen, shkeljen e konstatuar, duke specifikuar sinjalitiken rrugore ekzistuese, numrin e serisë së proces-verbalit të konstatimit që do të plotësojë;
- o) Plotëson proces-verbalin e konstatimit dhe një kopje e vendos në xhamin e mjetit;
- p) Mban përgjegjësi personale për cilësinë dhe saktësinë e plotësimit të fletëve të gjobave;
- q) Të përpilojë raport shërbimit kur është e nevojshme dhe ta dorëzojë tek eprorët më të afërt në afat, duke bërë dhe dokumentimin e tij;
- r) Të njoftojë eprorin për fillimin e kryerjes së shërbimit, në vijueshmëri kryen të njëjtën gjë edhe me ndryshimin e vendit të vendosjes sipas planit të veprimit;
- s) Të informojë sallën operative, për rastet kur gjatë kryerjes së detyrës i lindin probleme të cilat kërkojnë të zgjidhen në rastet e ngjarjeve më të papritura dhe kur i kërkohet ndihmë nga punonjësi të tjera të shërbimit;
- s) Me mbarimin e shërbimit, punonjësi paraqitet në vendin e vendosjes së shërbimit dhe i dorëzon eprorit raportin e shërbimit (nëse ka), mjetet lëvizëse dhe pajisjet për shërbim

Programi i Konkurimit : Ligji nr.89/2022 “Për Policinë Bashkiake”, ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

Fazat e konkurimit:

a-Testim me shkrim, 60 pikë

b-Testim i aftësive fizike, 20 pikë

c-intervista, 20 pikë

Kandidati duhet të paraqesë brenda datës 25.11.2024 me postë , pranë Sektorit të Marrëdhënieve me Publikun, ose në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore këto dokumenta :

1. Kërkesën për aplikim
2. Jetëshkrim
3. Fotokopje të Diplomës së shkollës.
- 4.Fotokopje të librezës së punës
- 5.Dëshmi kualifikimi për kompjuterin
- 6.Vlerësim pune nga punëdhënësi i mëparshëm
- 7.Fotokopje e kartës së idenditetit.
- 8.Dëshmi e gjendjes gjyqësore.
- 9.Vërtetim Prokurori, Gjykatë
- 10.Dëshmi e gjendjes shëndetësore